

Prodhimi i lartë i kullotave

Konsumimi i madh i ushqimit foragjer të cilësisë së lartë

Për ta rritur këtë, fermerit i duhet për kafshë një kullotë e gjatë dhe e dendur, e cila do të:

- **Prodhojë më shumë qumësht për lopë ose dele**
 - Në Orllan, kopeja ka rritur prodhimin e qumështit nga 15 deri 17 litra /ditë pas 3 ditëve që është përmirësuar kullota.
 - Në Zatriq, delet kanë prodhuar 150 ml qumësht më shumë në ditë nga kullota e përmirësuar.
- **Mundësojnë rritje më të shpejtë të kafshëve**
 - Dëmat (deri në 2 kg/ditë),
 - mëshqerrë qumështore (0.8 kg/ditë),
 - qingja (0.3 kg/ditë).



Kullota produktive

| Rendimenti më i lartë i ushqimit foragjer rrit madhësinë e kafshimit dhe konsumimin e ushqimit. | | |
|---|--------|--------|
| Kafshime për minutë | 60 | 60 |
| X | x | x |
| Mintuat e kullotjes në ditë | 500 | 500 |
| = | 30,000 | 30,000 |
| x | x | x |
| Ushqimi foragjer për kafshim | 0.3g | 0.5g |
| = | = | = |
| Konsumimi i ushqimit foragjer në ditë | 9 kg | 15 kg |

Bagëtit kafshojnë në një shkallë konstante (rreth 60 kafshime për minutë) dhe kullotin brenda një kohe konstante (rreth 500 minuta në ditë). Prandaj, një lopë arrin rreth 30,000 kafshime në ditë (delet pak më shumë).

Nëse kafshimet janë të mëdha, arrihet prodhim i mirë i qumështit ose shtohet në peshë.

Nëse kafshimet janë të vogla, prodhimi i qumështit është më i dobët e poashtu edhe prodhimi i mishit .

Fermeri për kafshet **nuk mund të kontrollojë shkallën e kafshimit ose gjatësinë e kullotës, por mund të kontrollojë gjatësinë dhe densitetin e ushqimit foragjer**, i cili i ofrohet kopes, në mënyrë që ato të kenë kafshime më të mëdha.

Për të pasur kullotë të dendur dhe të gjatë

- Sigurohuni që kullota të ketë lloje të mira të ushqimit foragjer (barërat dhe ushqimi leguminoz).
- Plehrimi, veçanërisht me Azot.

| Përmirësimi i kullotave | | |
|------------------------------|----------|----------------------|
| Vendi | Natyrall | I plehruar + me farë |
| -----Kg/m ² ----- | | |
| Orllan | 0.72 | 2.32 |
| Zatric | 0.95 | 2.12 |
| Acereve | 0.51 | 1.65 |
| Doganaj | 1.30 | 2.80 |
| Nashevc | 1.08 | 2.65 |

Në eksperimentet e udhëhequara nga Shoqata Kosovare e Hortikulturës, rendimenti është rritur për 2 deri 3 herë, aty ku janë mbjellur barërat dhe ku është aplikuar Plehrimi artificial.

Për të pasur kullotë të dendur dhe të gjatë

Ushqeni me ushqim foragjer duke shpërndarë dhe lënë kullotat periodikisht të pushojnë.



E tejkullotur → e kullotur mesatarisht → kullota e lënë për rritje

Kullotja tepër e shpeshtë zvogëlon zhvillimin e rrënjës dhe e bën kullotën më të ndjeshme ndaj thatësisë.

Prodhimi i ushqimit foragjer është më i madh nëse kullota lihet të pushojë.

Kullotat duhet të lihen të pushojë për së paku 2 javë midis kullotjes në pranverë dhe 4 javë midis kullotjes në verë dhe vjeshtë.



Kullotat mund të lihen të pushojnë nga

- Mbledhja ose grumbullimi në tufë i kafshëve,
- Lidhja e kafshëve,
- Përdorimi i gardhit të lëvizshëm elektrik.



Zgjatja e sezonës së kullotjes përmes rezervave të ushqimit foragjer nga kullotat pas ngrirjes

Rritja dhe zgjatja e kullotjes gjatë verës së vonshme është shumë kualitative pas ngrirjes sepse në ushqimi foragjer dominon vetëm gjethe; bari mund të ketë 20% proteinë të patretshme.

Hapat për krijimin e suksesshëm të rezervave:

1. Plehrimi me Azot te aplikohet në gushtin e hershëm,
2. Vlerësimi i saktë i prezencës ,sasisë / tonazhës,
3. Ushqimi foragjer përmes caktimit/lokalizimit te vendit .



Mendimet e shprehura në këtë publikim nuk paraqesin medoemos pikëpamjet e Agjencionit të Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.



PRODHIMI I LARTË I KULLOTAVE

